

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-194/13**

**Prishtinë,  
23 korrik 2015**

Në çështjen juridike të:

**J. T.**

Mali i Zi

**Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28622) të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 korrik 2015, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga J. T. e datës 12 gusht 2013 e regjistruar me numrin GSK-KPA-A-194/2013, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28622.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 i datës 5 shtator 2012 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28622.

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 15 mars 2007 pala ankuese, atëherë paraqitësi i kërkesës J. T. në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon të drejtën e pronësisë dhe ri-posedim të ngastrës kadastrale nr. 504/4, me sipërfaqe prej 2ha 7ari 63m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Rastavicë, Komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
  
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar këto dokumente:
  - Vendimin administrativ nr. 07-952/2-125/95 të lëshuar nga Shërbimi i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme i Komunës së Deçanit më 19 tetor 1994. Ky vendim përshkruan historinë e ndryshimeve të pronës së kërkuar në kadastrë. Për më tepër, i njëjti tregon se prona e kërkuar është e regjistruar në emrin e babait të paraqitësit të kërkesës (N. T.);
  - Gjetje ekspertize nga Dr. M. J. Zyra Kadastrale e Administrimit të Gjeodezisë, dhe Palujtshmërisë e datës 14 maj 1996, të përgatitur nga eksperti i cili synon të shpjegoj historikun kadastral të ngastrave me numrat 504 dhe 519;
  - Certifikatën e lindjes të nënës së palës ankuese të lëshuar nga Komuna e Nikshiqit (Mali i Zi) më 7 mars 1997;
  - Certifikatën e lindjes të paraqitësit të kërkesës të lëshuar nga Komuna e Cetinjes (Mali i Zi) më 15 gusht 2008;
  - Njoftimin përkujtimor që tregon se nëna e paraqitësit të kërkesës M. T. kishte vdekur më 11 janar 1996; dhe
  - Kopjen e letërnjoftimit të paraqitësit të kërkesës nr. CG00619201 të lëshuar nga autoritetet e Malit të Zi më 26 prill 2006.
  
3. Më 26 qershor 2008, AKP kishte bërë njoftimin e kërkesës. Prona e kërkuar ishte gjetur e lirë. Më 1 korrik 2010 AKP-ja përmes publikimit në gazetën e AKP-së kishte vërtetuar njoftimin e pronës së kërkuar. Gazeta dhe Lista ishin lënë te Kryesuesi i fshatit Rastavicë, si dhe në hyrje dhe në tabelën publike në dalje të fshatit. Shpallja e njëjtë (lista dhe gazeta) është publikuar në Komunën e Deçanit-Zyrën e Avokatit Publik, Zyrën Kadastrale të Komunës së Deçanit, Gjykatën Komunale të Deçanit dhe Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë. Gazeta e AKP-së është shpërndarë edhe te DRC, OSCE, UNHCR, dhe te Ombudspersoni.

4. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së të datës 26 shkurt 2009, vendimi administrativ nr. 07-952/2-125/95 i datës 19 tetor 1994 nuk ishte e mundur të verifikohet.

Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së të datës 2 korrik 2010, fleta poseduese dhe leternjoftimi të dorëzuar janë verifikuar pozitivisht.

5. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012 (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese mbi bazën se “[...] *paraqitësi i kërkesës pranon se bartësi i pretenduar i të drejtës së pronësisë i ka shitur pronat e kërkuara qysh në vitin 1963 ndërmarrjes shoqërore Ereniku*”. Vendimi konstaton se humbja e pretenduar e posedimit nuk mund të konsiderohet si rezultat i konflikti të vitit 1998-1999. Kjo domethënë se kërkesa bie jashtë jurisdikcionit të KKPK-ës.
6. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese të premtën e 12 korrik 2013. Ai ka paraqitur ankesë të hënen me 12 gusht 2013.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

7. Pala ankuese thekson se vendimi KKPK-së bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe në aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Sipas palës ankuese KKPK ka shqyrtuar kërkesën në mënyrë sipërfaqësore dhe ka vendosur pa bërë më parë vërtetimin e fakteve.
8. Ai ka sqaruar se nëna e tij M. T. [(në tekstin e mëtejshëm: bartësja e pretenduar e së drejtës pronësore (BDP)] është pronare e pronës së kërkuar. Ai ka theksuar se prona e kërkuar ishte humbur më 12 qershor 1999 dhe se humbja ishte si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë. Ai ka shtuar se ai nuk e din se kush është duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar.
9. Pala ankuese gjithashtu thekson se sipërfaqja e përgjithshme e pronës së kërkuar është mbi 7 hektarë dhe se vendimi i kundërshtuar që refuzon kërkesën për sipërfaqen prej 0ha 89ari 97m<sup>2</sup> është absurd.
10. Pala ankuese thekson se vendimi i kundërshtuar është kontradiktore sepse vendimi është për pronën për të cilën pala ankuese nuk ka bërë kërkesë ndërsa prona që ai ka kërkuar mungon. Ai gjithashtu ka shtuar se numri i fletave poseduese dhe numrat e ngastrës nuk përputhen.

11. Pala ankuese thekson gjithashtu se baza ligjore e vendimit të KKPK-së nuk është plotësisht e qartë. Kjo për shkak se procedurat e kryera gjyqësore lidhur me vërtetimin e së drejtës pronësore mbi pronat e kërkuara në Gjykatës Komunale të Pejës kundër NSH Ereniku janë ndërprerë për shkak të konfliktit të vitit 1998/1999 dhe kjo duhet të merret në konsideratë si humbje e pronës që ka rezultuar nga ai konflikt.
- Pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të miratoj ankesën e paraqitur, të shqyrtoj pretendimet për të kthyer mbrapsht vendimin e kundërshtuar dhe të dërgoj lëndën në rigjykim.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

12. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 03/L-079) mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale parasheh që *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e njoftimit të palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit lidhur me kërkesën, pala përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës mund të dorëzoj ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”*.
13. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 12 korrik 2013. Kështu, afati prej 30 ditëve ka skaduar më 11 gusht 2013 e meqë kjo datë i bie e diel, në bazë të nenit 126 paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore kjo nënkupton që ankesa konsiderohet të jetë paraqitur brenda afatit nëse paraqitet para përfundimit të ditës vijuese të punës. Pala ankuese ka paraqitur ankesë të hënën më 12 gusht 2013 prandaj ankesa e pranueshme.

#### *Meritat e ankesës:*

14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën e paluajtshme private por edhe se ai apo ajo është në pamundësi ta ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo që rezultojnë nga ky konflikt.

15. Megjithatë këtu siç duket nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë. Në ankesën e tij pala ankuese ka theksuar se procedura për vërtetimin e të drejtës pronësore lidhur me pronën e kërkuar, e kryer kundër Kombinatit Bujqësor Ereniku në Gjykatën Komunale të Pejës ishte ndërprerë për shkak të konfliktit 1998/1999. Është e qartë se kontesti lidhur me pronën e kërkuar kishte filluar më herët se sa ngjarjet në vitet 1998 dhe 1999. Fakti që ky proces ishte ndërprerë nga konflikti i armatosur nuk nënkupton se të drejtat pronësore ishin humbur për shkak të kësaj. Përkundrazi, është e qartë se BDP kidhte dhuruar pronën e kërkuar shumë kohë para konfliktit, në vitin 1963, dhe ajo nuk e kishte rifituar të drejtën pronësore në pronën e kërkuar, për shkak se procedura deri më tani ka qenë e paefekt. Këto fakte tregojnë se këto të drejta ishin humbur para konfliktit.
16. Konstatimi i lartpërmendur mbështetet në të gjeturat e ekspertit të datës 14 maj 1996 të ekspertit Dr. M. J. për Gjykatën Komunale të Pejës. Raporti, është dorëzuar nga vet pala ankuese. Raporti sqaron se bartësja e të drejtës pronësore (nëna e palës ankuese) dhe Kombinati Bujqësor Ereniku kishin lidhur një kontratë të blerjes në vitin 1963. Bazuar në kontratën e shitjes dhe dhurimit OV.br. 1649/63 të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Pejës, prona e kërkuar ishte bartur nga bartësja e së drejtës pronësore (nëna e palës ankuese) nën pronësi të Kombinatit Bujqësor “Ereniku” nga Gjakova. Raporti i njëjtë përmend se procedurat në Gjykatën Komunale të Pejës lidhur me lëndën me numër 229/95 [(përcaktimi i pavlefshmërisë së kontratës së shitjes dhe dhurimit (OV.br. 1649/63)] për kthimin e pronës së kërkuar ishte iniciuar në vitin 1995. Nuk është kontestuese se procedura deri më tani është e parezultat.
17. Ankuesi me tutje thekson se KKPK-ja ka trajtuar pronën e gabuar për shkak se KKPK-ja ka cituar ngastrën nr. 504/4 vetëm në sipërfaqe prej 00.89.97 ha dhe se Ankuesi thotë se ajo është më shumë se 7 hektarë. Ankuesi nuk kishte paraqitur ndonjë dokument me kërkesën e tij në lidhje me pronën e kërkuar dhe bile as edhe informatë në lidhje me pronën e kërkuar. Bazuar në informatat e mjaftueshme KKPK-ja ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme gjendjen faktike në lidhje me pronën e kërkuar. Ankuesi edhe në ankesën e tij nuk ka ofruar ndonjë provë në bazë të së cilës vlerësimi i fakteve nga ana e AKP/KPKK në rasin konkret të pronës së kërkuar do të ishte i gabuar.
18. Gjykata Supreme konstaton se kontesti lidhur me të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar nuk është i ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999 dhe KKPK-ja ka vendosur drejtë se KKPK-ja nuk ka jurisdicioni.
19. Në bazë të asaj që u tha më lartë ankesa duhet të hidhet poshtë si e pabazuar.

**Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**